

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet teknike për objektin e prokurimit me titull: “**BLERJE PREPARATE PËR UJIN E PISHINËS**” u bazuan në Vkm-në nr. 835, datë 30.11.2022 Për miratimin e rregullores “Për kërkesat higjieno-sanitare të pishinave”. Pishinat duhet të plotësojnë kërkesat higjieno-sanitare dhe mjedisore lidhur me karakteristikat e ujit që përdoret, lëndët që përdoren për trajtimin e ujit, pikat e marrjes së mostrave, kërkesat e temperaturës dhe lagështisë, ventilimit, ndriçimit dhe akustikës. Kërkesat higjieno-sanitare dhe mjedisore u referohen karakteristikave të ujit të përdorur në impiantin e pishinës, të kushteve termo-higrometrike, të ajrimit, ndriçimit dhe akustike. Për trajtimin e ujit që futet në basen lejohet përdorimi i lëndëve të mëposhtme dezinfektuese, flokulante dhe korektuese të pH:

1. ACIDTRICHLOROISOCIANURIK (TCCA)

Me ndërhyrje të shpejtë me ujin, granular, i bardhë, i ambalazhuar me material fibër, me peshë 50 kg. Përmbajtja e klorit aktiv mbi 90 %.

2. STABILIZUES PH (-) GRANULUAR, (NaHOSA-4).

I granular, me ambalazh plastik me peshë 50 kg kundra lagështirës.

3. ALKACID

Trajtues kundra algave me ambalazh plastik me peshë 30 litra, kundra lagështirës.

4. TRAJTUES FLOKULACIONI

Eliminon nga uji pezullitë mikroskopike që ndotin ujin, kundra lagështirës.

5. MIREMBAJTJA E BAZENIT

Pishinë normale me rreth 2000 m³ ujë.

6. TRANSPORTIMI I MALLRAVE DO TË BËHET NGA VETË FURNIZUESI

Malli objekt prokurimi duhet të jetë i shoqëruar me dokumentacionin përkatës;

- Certifikatën e garancisë së mallit;
- Datën e skadencës;
- Të ambalazhuara sipas standarteve;

Materialet të jenë cilësore sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të lejuara sipas ligjeve në fuqi.

Afati i skadencës të jetë jo më pak se 1 vit.

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt i këtij prokurimi janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, gjithashtu specifikimet teknike janë përcaktuar në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi.

GRUPI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE